REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY

| | | | |
|---|---|---|---|
| Njesia Org. / Org. Jedin / Org Unit | 013 | Nr. Prot. / Br. Prot / Prot.No: | 402 |
| Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages | / | Data: / Datum: / Date: | 01.03.22 |

PRISHTINË/A NO.1

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE
»HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.
Nr. 01-13/01
Dt. 28.02.2022
PRIZREN

Hidroregjioni Jugor

Kompania Rajonale e Ujësjellësit
"Hidroregjioni Jugor" SH.A.
"Vatrat Shqiptare", p.n. 20000 Prizren
Tel/Fax; 029/ 244-150 029/ 244-107
E-mail; sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

---

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit"Hidroregjioni Jugor"Sh.A me seli në Prizren në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet vjetore dhe tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022 mori këtë:

# RAPORTI VJETOR-2021

Vendimi : 01-13/01

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve miratoi njëzëri raportin vjetor për vitin 2021 në mbledhjen e gjashtë (6) të mbajtur me datë 28.02.2022.

| | Delegoi | Aprovoi |
|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Kryeshefi Ekzekutiv Zenel Zenelaj | Kryesuesi i BpD Arbëror Prekazi |
| Nënshkrimi | | |
| Data | 28.02.2022 | 28.02.2022 |

Hidroregjioni Jugor

# 2021

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org. / Org. Jedin / Org Unit 011 3 Nr. Prot. / Br. Prot / Prot.No: 402
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages / Data: / Datum: / Date: 01.03.22
PRISHTINË A NO.1

# RAPORT VJETOR





K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A
Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000
www.hidroregjioni-jugor.com
info@hidroregjioni-jugor.com
konsumatori@hidroregjioni-jugor.com

# 1.Përmbajtja

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | 2 |
| Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. ,,HIDROREGJIONI JUGOR" | | | 4 |
| **2.** | **RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE** | | 6 |
| | **2.1** | **Të dhënat kryesore gjatë vitit 2021** | 6 |
| | 2.2 | **Te dhenat per drejtot jo- ekzekutiv** | **8** |
| | 2.2.1 | **Emrat e drejtoreve te bordit te drejtoreve (Te përkohshëm)** | **8** |
| | 2.2.2 | **Numri i takimeve te bordit te drejtoreve** | **8** |
| | 2.2.3 | **Numri i takimeve te Komisionit te Auditimti** | **8** |
| | **2.2.4** | **Informacionet e tjera te bordit gjate vitit 2021** | **9** |
| | **2.3** | Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividenten | **13** |
| | **2.4** | **Kredit e rendesishme te nenshkruara apo paguara gjate vitit** | **13** |
| | **2.5** | **Investimet gjate vitit 2021** | **13** |
| **3** | | **RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV** | **14** |
| | **3.1** | **Ngjarjet kryesore te vitit** | 14 |
| | 3.1.1 | **Aktivitetet nga Departamenti Teknik** | 14 |
| | 3.1.2 | **Situata e furnizimit – NJ.P. - Janar –Dhjetor 2021** | 14 |
| | 3.1.3 | **Aktivitetet ktyesore** | 14 |
| | 3.1.4 | **Problemet e hasura gjatë këtij periudhe** | 20 |
| | 3.1.5 | **Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake** | 20 |
| | 3.1.6 | **Masat e propozuara për periudhën në vazhdim** | 20 |
| | **3.2** | **Pasqyrat e performancave operative nga Shërbimi Teknik** | 21 |
| | **3.2.1** | **Prodhimi – Janar-Dhjetor 2020-2021** | 21 |
| | **3.2.2** | **Prodhimi – Realicimi i caqeve -2021** | 23 |
| | **3.3** | **Aktivitetet nga Departamenti Rajonal Për Konsumatorë** | **24** |
| | **3.3.1** | **Aktivitetet kryesore- Janar –Dhjetor 2021** | **24** |
| | **3.3.2** | **Raport I ankesave teknike dhe komerciale** | **24** |
| | **3.3.3** | **Raporti ekipes se inspektimit dhe shkyçjes** | 24 |
| | **3.3.4** | **Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe** | 25 |
| | **3.3.5** | **Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake** | 26 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | 3.3.6 | Masat e propozuara për periudhën në vazhdim | 26 |
| | | | |
| | 3.4 | Performancat nga Departamenti për Konsumatorë- Nr. I Faturave | 27 |
| | 3.4.1 | Numri i Faturave- Janar-Dhjetor-2021 | 27 |
| | 3.4.2 | Numri i Faturave- 2020-2021 | 29 |
| | 3.4.3 | Numri i Faturave- Janar-Dhjetor-2021 (Caqet – PB-2021) | 30 |
| | | | |
| | 3.5 | Performancat nga Departamenti për Konsumatorë - Faturimi – m3 | 31 |
| | 3.5.1 | Faturimi – m3- Janar-Dhjetor-2021 | 31 |
| | 3.5.2 | Faturimi – m3- 2020-2021 | 32 |
| | 3.5.3 | Faturimi – m3- Janar-Dhjetor-2021 (Caqet – PB-2021) | 33 |
| | | | |
| | 3.6 | Performancat nga Departamenti për Konsumatorë- Faturimi – € | 34 |
| | 3.6.1 | Faturimi €- Janar-Dhjetor-2021 | 34 |
| | 3.6.2 | Faturimi €- 2020-2021 | 35 |
| | 3.6.3 | Faturimi €- Janar-Dhjetor-2021 (Caqet – PB-2021) | 36 |
| | | | |
| | 3.7 | Performancat nga Departamenti për Konsumatorë - Arkëtimi – € | 37 |
| | 3.7.1 | Arkëtimi €- Janar-Dhjetor-2021 | 37 |
| | 3.7.2 | Arkëtimi €- 2020-2021 | 39 |
| | 3.7.3 | Arkëtimi €- Janar-Dhjetor-2021 (Caqet – PB-2021) | 40 |
| | 3.7.4 | Tarifat €- 2015 -2021 | 42 |
| | | | |
| | 3.8 | Raporti nga Departamenti financiar | 43 |
| | 3.8.1 | Aktivitetet kryesore - Janar –Dhjetor 2021 | 43 |
| | 3.8.2 | Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe | 44 |
| | 3.8.3 | Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake | 44 |
| | 3.8.4 | Masat e propozuara për periudhën në vazhdim | 44 |
| | | | |
| | 3.9 | Performancat Financiare - Shpenzimet € | 45 |
| | 3.9.1 | Shpenzimet € - 2020-2021 | 45 |
| | 3.9.2 | Shpenzimet € - Janar-Dhjetor -2021 (Caqet- PB- 2021) | 48 |
| | | | |
| 4 | | Personeli | 49 |
| | 4.1 | Personeli – Janar-Dhjetor 2020-2021 | 49 |
| | 4.2 | Personeli – Janar-Dhjetor – 2021 (CAQET- PB-2021) | 50 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **5** | | **TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCAVE** | 51 |
| | **5.1** | **Performancat – Janar-Dhjetor - 2021** | 51 |
| | **5.2** | **Performancat – Janar-Dhjetor – 2020-2021** | 52 |
| | **5.3** | **Performancat – Janar-Dhjetor – 2021 ( Caqet – PB – 2021)** | 53 |
| **6** | | **Aktivitetet e Departamentit Administrativ** | **55** |
| | **6.1** | **Aktivitet kryesore** | **55** |
| | 6.2 | Raport i zyres ligjore | 60 |
| | **6.3** | Lëndet që rrezikojne Kompaninë | **62** |
| **7** | | **RAPORT I AUDITORIT** | 64 |
| | 7.1 | Raport i auditorit te brendshem | 64 |
| **8** | | KTIVITETET E ZYRËS SË PROKURIMIT | 68 |
| **9** | | TRANSAKSIONET KRYESORE | 73 |
| **10** | | **PASQYRAT FINANCIARE** | 74 |
| **11** | | Prespektiva per vitin e ardhshëm | 78 |
| **12** | | Investimeve e realizuara – Janar-Dhjetor 2021 | 79 |
| **13** | | Plani I investimeve kapitale- kanalizim per vititn 2021 | 80 |
| **14** | | Raportet nga Menagjeret e projekteve | 81 |
| | | **ORGANOGRAMI** | 88 |

# ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit,viti 2021




LEGJENDA:

| | |
|---|---|
| 05 | Zona e shërbimit |
| 05 | Qytetet me ujë |
| 75 | Fshatrat me ujë që menaxhohen nga HRJ |
| 118 | Venbanimet pa shërbime të ujësjellësit |

Punoi: Shërbimi TEKNIK

# 2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

## 2.1 Të dhënat kryesore gjatë vitit 2021

**FURNIZIMI**

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes brenda 24 orëve në ditë, për muajt Janar-Dhjetor të vitit 2021, në nivel regjional, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë kryesisht i rregullt por i shoqëruar me ulje presioni në disa zona më problematike dhe reduktime parciale të furnizimit.

Në NJP – Prizren, reduktimet janë aplikuar në qytetin e Prizrenit ne disa zona (disa zona të qendrës së qytetit dhe zonat e lagjeve „Bajram Curri“, „Jeta e Re, pjeserisht „Arbana“) sikurse edhe reduktime parciale në disa pjese rurale. Në njësitë tjera operuese, Suharekë, Malishevë dhe Dragash nuk janë shfaqur probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes në pjesët urbane, me prëjashtim të aplikimit të reduktimeve parciale të planifikuara në disa zona rurale.

Faktori kryesor që ka ndikuar drejtpërdrejtë në destabilizimin e furnizimit me ujë të pijes dhe vazhdon të ndikojë është zvogëlimi i kapaciteteve të burimeve ujore si rezultat i kushteve shumë të pavolitshme atmosferike për resurset ujore që kanë mbretëruar për një periudhë të gjatë kohore dhe vazhdojnë të mbretërojnë aktualisht. Faktorët tjerë gjithashtu me ndikim serioz në vështirësitë e furnizimit, uljen e presionit dhe aplikimin e reduktimeve janë keqpërdorimet enorme të ujit të pijes, defektet të shumta si pasojë e infrastrukturës parciale tejet të amortizuar dhe ndërprerjeve të shpeshta të planifikuara dhe të paplanifikuara të energjisë elektrike nga KEDS-i.

Në muajt Janar-Dhjetor, bazuar në faktorët e sipërshënuar, përkundër vështirësive të sipërevidentuara, në përgjithësi kemi realizuar furnizimin kualitativ me objektiv në arritjen e standardeve aplikative të cilësisë 100% të ujit të pijes dhe janë ndërmarrë aktivitetet e duhura në operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

**UJI I PRODHUAR**

Për muajt Janar-Dhjetor 2021, në nivel regjional janë raportuar prodhim të ujit **16,928,504.00 m³**, krahasuar me vititn 2020 kemi një rritje të prodhimit të ujit të pijes prej **408,272.00 m³.**

**FATURIMI - m3**

Gjatë vitit 2021 në nivel regjional janë faturuar **7,718,785m$^3$** me një rritje të faturimit prej **+330,959 m$^3$ (+4.48%)** krahasuar me vitin 2020.

**FATURIMI - €**

Gjatë vitit 2021 në nivel regjional janë faturuar **5.194.383,79 €** me një rritje të faturimit prej **+641.519,03 €** **(+14.09%)** krahasuar me vitin 2020.

**ARKËTIMI - €**

Gjatë vitit 2021 në nivel regjional janë arkëtuar **5.148.530,37 €** me një rritje të arkëtimit prej **+982.209,09 €** **(+23.57%)** krahasuar me vitin 2020.

**UJI I PAFATURUAR**

UPF vazhdon të mbetet një ndër sfidat kryesore të të gjitha departamenteve të kompanisë. Në kordinim me të gjitha sherbimet brenda Kompanisë dhe në mbështetje të donatoreve të huaj dhe instutucioneve vendore kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogelimin e UPF-se.
Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogelimin e UPF-së që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve në terësi.
Shërbimi Teknik me të gjithë sektoret e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e tyre kualitativisht në kohe optimale.
Raportet tregojnë që UPF në nivel regjional për vitin 2021 është **54.40 %** me një rënie prej **0.88 %** krahasuar me vitin 2020.

**SHPENZIMET - €**

Gjatë vitit 2021 në nivel regjional shpenzimet kanë arritur në **3.945.633,22 €** me një rritje të shpenzimeve prej **+2.246,97 €** **(+0.06%)** krahasuar me vitin 2020.

**MBULIMI OPERATIV**

Gjatë vitit 2021 në nivel regjional Kompania ka arritur të ketë mbulim operativ prej 1.30 apo +1.202.897,15 € mbi shpenzimet operative.

## 2.2 TË DHËNAT PËR DREJTOR – JO- EKZEKUTIV

### 2.2.1 Emrat e drejtorëve të përkohshëm të bordit të drjetorëve

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve është Emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 31/39 të datës 13.10.2021. Bordi është përbërë fillimisht nga 4 Drejtorë të Bordit në përbërje prej:

- **Arbëror Prekazi**-kryesues,
- **Nurten Sktash-Beden**-anëtare,
- **Saxhide Mustafa** – anëtare, dhe
- **Seat Bilibani** – anëtar.

Nga dhjetori 2021 funksionon me 3 Drejtor të Bordit, kur Nurten Sktash-Beden Kryesuesja e Komisionit të Auditimit njëherit edhe anëtare e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve me datë 26.11.2021 ka njoftuar për dorëheqje nga Bordi dhe Komisioni i Auditimit.

### 2.2.2 MBLEDHJET E BORDIT TË PERKOHSHEM TË DREJTORËVE K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR" SH. A- PRIZREN

| NR. | DATA | VENDI | VËREJTJE |
|---|---|---|---|
| 1 | 25.10.2021 | Prizren | |
| 2 | 29.10.2021 | Prizren | |
| 3 | 22.11.2021 | Prizren | |
| 4 | 30.12.2021 | Prizren | |
| 5 | 30.12.2021- MPVA | Prizren | |

### 2.2.3 MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A- PRIZREN

| NR. | DATA | VENDI | VËREJTJE |
|---|---|---|---|
| 1 | 16.11.2021 | Prizren | |

## 2.3 Informacione të tjera të bordit gjatë vitit 2021

Raporti vjetor i Bordit të Përkohshëm të Drejtoreve në KRU"Hidroregjioni Jugor"SHA në Prizren, në formë përmbledhëse përfshin aktivitetet kryesore të Bordit të Përkohshëm Drejtoreve të realizuara gjatë vitit 2021.

**Gjatë vitit 2021 Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve ka mbajtur katër (4) takime të rregullta mujore. Sipas procesverbaleve takimet e Bordit janë mbajtur me këto data: 25.10.2021; 29.10.2021; 22.11.2021; 30.12.2021 dhe MPVA me 30.12.2021.**

Në këto takime Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve përveç diskutimeve të frytshme poashtu ka marr veprimet si vijon:

- Aprovimi i Plan Biznesit për vitin 2022-2024,
- Aprovimi I Raportit të Kompanisë për TM3-2021,
- Është mbajtur Mbledhja së Përgjithshme Vjetore me Aksionarin në K.R.U."Hidroregjioni Jugor" Sh. A Prizren (për vitin 2020).
- Aprovimi I Pasqyrave Financiare të Audituara nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020 ne MPVA.
- Aprovimi I Raportit vjetor për vitin 2020 ne MPVA.
- Aprovimi I Raporteve të Zyrtarit të auditimit të brendshëm.

- **Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e parë të mbajtur me 25.10.2021** është bërë prezantimi i anëtareve të Bordit dhe njoftimi i tyre me U.D Kryeshefin dhe Menaxhmentin e Lartë në KRU"Hidroregjioni Jugor"Sh. A,Prizren. Nga UD së Kryeshefit Ekzekutiv në këtë takim u paraqit raport njoftues për Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve që përfshinte zonën menaxhuese, realizimi i caqeve të planifikuara në PB, investimet, rreziqet e kompanisë dhe performancen operative dhe financiare të Kompanisë.
- **Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 29.10.2021** në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Plan-Biznes si dhe në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike për Plan-Biznes Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve pas shqyrtimit të bërë njëzëri **miratoi** Plan Biznesin e KRU" Hidroregjioni Jugor"Sh. A, për vitin 2022-2024, duke përfshirë edhe Strukturën Organizative të Kompanisë .
- Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen Nenit 21 Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të KRU "Hidroregjioni Jugor"SHA në këtë takim mori Vendim të

përgatitet dhe te publikohet Konkursi për Kryeshef Ekzekutiv të KRU"Hidroregjioni Jugor"Sh. A Prizren.

- **Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 22.11.2021,** në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, pas shqyrtimit të bërë të raportit tremujor njëzëri **miratoi** Raportin Operativ dhe Financiar për TM-3 / 2021, të KRU" Hidroregjioni Jugor"Sh.A .

- Mbështetur në pozicionin e pagave të Plan- biznesit për vitin 2021 dhe bazuar në Kërkesë-Propozimin e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit dhe menaxhmentit të KRU"Hidroregjioni Jugor"Sh A si dhe pas aprovimit Kërkesë-Propozimit nga Komisioni i Auditimit, nga Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve njëzëri është aprovuar rritja e vlerës së koeficientit nga 85 euro në 90 €uro për të gjithë të punësuarit në KRU"Hidroregjioni Jugor"Sh A. Ky vendim ka hyrë në fuqi nga muaji Nëntor i vitit 2021 dhe do të jetë pjesë përbërëse e kontratave të punës për punonjësit e KRU"Hidroregjioni Jugor"Sh A.

- **Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 30.12.2021,** pas raportimit nga Auditori i Brendshëm si dhe pas shqyrtimit të bërë aprovoj njëzëri raportin final të auditimit të procesit të prokurimit si dhe raportin final i auditimit, lidhur me procesin e financimit të projektit "Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura" nga Ministria e Ekonomisë/NJPMNP, të prezantuara nga Auditori i Brendshëm i Kompanisë.

- Pas njoftimit nga Auditori i Brendshëm për plotësimet apo përmirësimet e bëra në plan Strategjik dhe vjetor të AB sipas kërkesës se Komisionit te Auditimit, u nënshkrua Plani Strategjik dhe vjetor me përmirësime.
- Në këtë takim Kryesuesi i Bordit bazuar në Ligjin për NP dhe Kodin e Qeverisjes Korporatave për Ndërmarrjet Publike, propozoi që Zv. Kryesues i Bordit të jetë znj. Saxhide Mustafa e cila mund të zëvendësoj Kryesuesin nëse mungon në takim të Bordit. Bordi aprovoi njëzëri për zv. Kryesuese të Bordit znj. Saxhide Mustafa, e cila do të zëvendësoj Kryesuesin e Bordit nëse mungon në takim të Bordit.
- Në këtë takim është shqyrtuar kërkesa e Kompanisë e paraqitur nga UD së Kryeshefit Ekzkeutiv në emër të menaxhmentit të Kompanisë, për shpërblim të punonjësve te kompanisë me rastin e vitit të Ri 2022 me vlerën 100euro. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve pas shqyrtimit të bërë si dhe duke u bazuar në atë se është rritur vlera e koeficienteve punonjësve në dy muajt e fundit, miratoi njëzëri kërkesën për shpërblim të punonjësve të kompanisë me rastin e vitit të Ri - 2022 me nga 50.00 euro neto.
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve bazuar ne Udhëzimin administrative Nr 07/2017 për rregullimin e proceduarave të konkursit në sektorin publik, vendosi që intervista me shkrim për kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë për pozitën e punës Kryeshef Ekzekutiv të mbahet me datë 06.01.2022 në ora 11:00 në zyrat e Kompanisë në Prizren.

- **Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e MPVA me datë 30.12.2021,** në Mbledhjen Përgjithshme Vjetore me Aksionarin me Vendim miratoi Pasqyrat Financiare të Audituara nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020.

- Pasi u shqyrtua raporti vjetor i Kompanisë për vitin 2020 nga Bordi i Përkohshëm i drejtorëve në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin u miratua njëzëri Raporti vjetor për vitin 2020.

- **Rekomandimet e dala në MPVA:**

- Kompania Hidroregjioni Jugor SH.A, në të ardhmen në Raportin Vjetor duhet të parashikoj rreziqet të mundshme me të cilat mund të ballafaqohen ndërmarrja qoftë në mënyre direkte apo indirekt p.sh. ndonjë rast siç u ballafaqua Komuna e Deçanit gjatë vitit, apo ndonjë rrezik tjetër që mundeni me paraparë qoftë si Bord apo si menaxhment;
- ndërmarrja duhet me pasur një planë të detajuar për zvogëlimin e humbjeve të natyrës komerciale dhe teknike në rrjet të ujësjellësit;
- raporti i punësimeve gjinore është mirë të shikohet dhe çdo herë me tentuar me i jap përparësi gjinisë femërore, personave me aftësi të kufizuar etj, me qëllim që të përmbushim të drejtat e grupeve të margjinalizuara të garantuara me ligj;
- raportin ndërmjet shpenzimit të pagave dhe te hyrave të gjithëmbarshme është mirë më u zvogëluar .

**Aktivitetet tjera të Bordit Përkohshëm të Drejtorëve gjatë vitit 2021**

- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve prej emërimit me date 13.10.2021 ishte në kontakt të vazhdueshëm me Menaxhmentin e Kompanisë.
- Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakt direkt por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani.
- Është mbikëqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për U.D se Kryeshefit Ekzekutiv.
- Në takimet e rregullta janë mbikëqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme.
- Është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i raporteve tremujore për vitin 2021 (duke u bazuar në raportet mujore); dhe në kornizën ligjore të Ligjit për NP.
- Janë dorëzuar në NJPMNP të aprovuara raportet si në vijim: Raporte tremujore për aksionarin (ME); ( raporti TM3, raporti vjetor për 2020, Raporti i auditimit nga ZKA për vitin 2020) dhe raporte mujore për ARRU-në.

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve falënderon Kryeshefin Ekzekutiv, stafin menaxhues të Kompanisë dhe gjithë punëtorët për angazhimin e tyre në rritjen e performancave të kompanisë dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Bordi shprehë një mirënjohje të veçantë për të gjithë donatorët (KFW, Dorsch-CDI), ME dhe Komunat për bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e shumë projekteve për në interes të Kompanisë.

**Raport vjetor i punës së Komisionit të Auditimit për vitin 2021.**

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit të KRU"Hidroregjioni Jugor"SHA në Prizren, në formë përmbledhëse përfshin aktivitetet kryesore të Komisionit të Auditimit të realizuara gjatë vitit 2021.
Duhet theksuar se gjatë këtij viti, për shkak të mungesës së Bordit të Drejtorëve, është mbajtur vetëm një takim i Komisionit të Auditimit. Ndërsa shumë çështje janë shqyrtuar drejtpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve.
Bazuar në procesverbalin zyrtar të mbajtur, takimi i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 16.11.2021, me përbërje të plotë të 3 anëtarëve, sikurse: Nurten Sktash-Beden/Kryesuese e Komisionit të Auditimit, Saxhide Mustafa – anëtare e K.A dhe Seat Bilibani – anëtar i K.A.

Në këtë takim, janë diskutuar dhe shqyrtuar disa tema, me ç 'rast edhe janë marrë vendime, të paraqitura si në vijim:

- Shqyrtimi i raporteve të mbetura të pa shqyrtuara - raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm (për shkak të mungesës të Komisionit të Auditimit, shqyrtimi i gjeturave dhe rekomandimeve);
- Shqyrtimi i planit vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022;
- Shqyrtimi i planit strategjik të punës së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2022 - 2024, si dhe
- Tema të tjera.

Konkluzionet, vendimet dhe rekomandimet e dhëna të Komisionit të auditimit, kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit pajtohet me rekomandimin e dhënë nga Auditori i Brendshëm që të minimizohen blerjet me operatorët që nuk janë deklarues të Tvsh-së.
- Komisioni i Auditimit rekomandoi që të punohet rregullore e brendshme e Kompanisë që i përcakton limitet e blerjeve dhe shpenzimeve nga blerjet me para të gatshme apo pa prokurim.
- Komisioni i Auditimit vlerësoi që për të informuar Bordin, të përgatitet lista që i përmban të gjitha detajet e mundshme lidhur me materialin e vjetërsuar në depo apo që është jashtë përdorimit me vlerë zero.
- Për të diskutuar në Bord nga Komisioni i Auditimit u kërkua raport nga shërbimi me konsumatorë lidhur me punën e inspektoratit në terren duke përfshirë edhe rezultatet e terrenit, përqindjen e mbulimit te inspektimit në teren dhe planin e veprimit të tyre si dhe realizimi i planit të punës së tyre.

- Komisioni i Auditimit aprovoi që të vazhdohet me auditime nga Auditori i Brendshëm i Kompanisë sipas planit të auditimit për vitin 2021.
- Komisioni i Auditimit aprovoi planin vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2022 si dhe Planin Strategjik i punës së Auditorit të Brendshëm, për periudhën 2022 - 2024, me disa plotësim ndryshime.
- Komisioni i Auditimit aprovoi kërkesë - propozimin e menaxhmentit të Kompanisë për rritje të vlerës së koeficientit të pagës në Kompani duke e deleguar në Bord për aprovim.

## 2.3 Informacionet lidhur me kapitalin dhe difidenten

Nuk ka pasë pagesa ne emër te dividentes

## 2.4 Kredit e rëndësishme të nënshkruara apo paguara gjatë vitit 2021

Pagesa e kredisë per vitin 2021 ne shumë prej 14.762.71 €

## 2.5 Investimet gjatë vitit 2021

**TOTAL INVESTIMET - 2021**

| NR | INVESTITORI | SHUMA- € |
|---|---|---|
| 1 | KRU, H.JUGOR" SH.A | 183,585.72 € |
| 2 | K.K- PRIZREN | 110,922.81 € |
| 3 | K.K- Suharekë | 24,978.81 € |
| **4** | **Vlera e investimeve te regjistruara** | **319,487.34 €** |
| **6** | **Vlera e investimeve ne vijim** | **524,165.73** |
| **7** | **TOTAL** | **843,653.07 €** |

**INVESTIMET NË VIJIM**

| Nr. | projekti | Investitori | SHUMA- € |
|---|---|---|---|
| 1 | Impianti UZ | KfW | 49,614.76 |
| 2 | Impianti UZ | KfW | 443,171.61 |
| 3 | Rrjeti I ujit – Peqan- SU | KK- Suharekë | 23,855.00 |
| 4 | Vendosja e ujematesave- Reqan- Su | KRU- Hidroregjioni Jugor | 7,523.73 |
| | | | **524,165.10 €** |

# 3. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

## 3.1 NGJARJET KRYESORE TË VITIT

### 3.1.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI TEKNIK

### 3.1.2 SITUATA E FURNIZIMIT – JANAR – DHJETOR 2021

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes brenda 24 orëve në ditë, për muajt Janar-Dhjetor të vitit 2021, në nivel regjional, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë kryesisht i rregullt por i shoqëruar me ulje presioni në disa zona më problematike dhe reduktime parciale të furnizimit.
Në NJP – Prizren, reduktimet janë aplikuar në qytetin e Prizrenit ne disa zona (disa zona të qendrës së qytetit dhe zonat e lagjeve „Bajram Curri“, „Jeta e Re, pjesërisht „Arbana“) sikurse edhe reduktime parciale në disa pjese rurale. Në njësitë tjera operuese, Suharekë, Malishevë dhe Dragash nuk janë shfaqur probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes në pjesët urbane, me përjashtim të aplikimit të reduktimeve parciale të planifikuara në disa zona rurale.
Faktori kryesor që ka ndikuar drejtpërdrejtë në destabilizimin e furnizimit me ujë të pijes dhe vazhdon të ndikojë është zvogëlimi i kapaciteteve të burimeve ujore si rezultat i kushteve shumë të pavolitshme atmosferike për resurset ujore që kanë mbretëruar për një periudhë të gjatë kohore dhe vazhdojnë të mbretërojnë aktualisht. Faktorët tjerë gjithashtu me ndikim serioz në vështirësitë e furnizimit, uljen e presionit dhe aplikimin e reduktimeve janë keqpërdorimet enorme të ujit të pijes, defektet të shumta si pasojë e infrastrukturës parciale tejet të amortizuar dhe ndërprerjeve të shpeshta të planifikuara dhe të paplanifikuara të energjisë elektrike nga KEDS-i.
Në muajt Janar-Dhjetor, bazuar në faktorët e sipërshënuar, përkundër vështirësive të sipër evidentuara, në përgjithësi kemi realizuar furnizimin kualitativ me objektiv në arritjen e standardeve aplikative të cilësisë 100% të ujit të pijes dhe janë ndërmarrë aktivitetet e duhura në operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

### 3.1.3 AKTIVITETET KRYESORE JANAR-DHJETOR 2021

- Riorganizimi i stafit sipas nën sektorëve dhe zëvendësimet e kompletimet e ekipeve punuese me punëtor brenda shërbimit respektivisht për punëtorët e pensionuar dhe punëtorëve në mungesë, shoqëruar me dokumentacionin administrativ adekuat.
- Angazhimet dhe menaxhimet e përditshme te punëve në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e vendit të punës dhe jashtë tij për operim dhe funksionimit optimal të Departamentit Teknik dhe Kompanisë.

- Raportet mujore, kuartale, vjetore dhe raporte tjera profesionale për ARRU, Institucionet lokale e vendore, menaxhmentin e Kompanisë dhe të tjerë.
- Takimet e rregullta të menaxhmentit, takimet me donatore, me institucionet komunale e qeveritare, me konsumatorë, takimet në platformën dixhitale, organizuar nga Shukos , konferenca e ujit, HTWC-SCADA sistem e të tjera, shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike.
- Takimet e rregullta për harmonizimin e projekteve investive dhe dokumentacioneve përkatëse teknike me komunën e Prizrenit dhe komunat tjera, me Qeveri dhe Institucione potenciale financiare, përpilimi dhe finalizimi i projekt propozimeve te përgatitura nga DT. Shtate marrëveshje bashkë investimi me komunat, 4 të përfunduara dhe 3 në proces ekzekutimi.
- Aplikimi i programit MMS ne njësitë punuese Prizren, Suhareke, Malisheve dhe Dragash.
- Programimi, finalizimi dhe aplikimi i programit MMA në të gjitha njësitë punuese.
- Auditimet dhe evaluimet teknike me bashkëpunëtorët e DT te raporteve për institucionet kompetente dhe projekteve te papërfunduara, ato ne ekzekutim e sipër, aplikacionet softwerike dhe menaxheriale, etj.
- Mbikëqyrja profesionale dhe përfundimi i projektit „Stacioni pompues – Topallnica dhe njësitë tjera operuese brenda NJP-Suhareke“.
- Shqyrtimi dhe analizat profesionale te sistemeve elektropompuese dhe përgatitja e dokumentacionit teknik për prokurim për elektropompa, vegla pune dhe makineri e mekanizëm përcjellës.
- Aplikimi dhe procedimi i shkresave zyrtare qe lëshon DT - Përgjigjeve ne kërkesa, Lejeve, Vendimeve dhe Pëlqimeve komfor Rregulloreve te Kompanisë.
- Shkëmbimet e te dhënave teknike e financiare finale përmes komunikimit dixhital e platformës vizuele me KFW - Gjermani për përmbylljen e projektit te gyp sjellësit te qytetit te Prizrenit – investim donator nga Qeveria Gjermane.
- Përfundimi i punimeve te projektit: „ Instalimi i gyp sjellësit ne rr, Remzi Ademaj - Prizren“ dhe procedimi final për zyrtarizim si aset i kompanisë,
- Menaxhimi i projektit: “Inspektimi me CCTV dhe shërbimet tjera për rrjetin e kanalizimit në Prizren”, sipas programit: Faza V – „Mënjanimi i ujërave të zeza në Europën Jugperëndimore“ , për projektin; “Inspektimi me CCTV dhe shërbimet tjera për rrjetin e kanalizimit në Prizren”, investuar nga KFW dhe Qeveria e Kosovës. Pranim-dorezimi i dokumentacionit dhe materialit final nga kontraktori konform kritereve kontraktuale dhe permbyllja e projektit. Raporti final, rekomandimet dhe hartimi i prezantimit vizual.

- Vazhdimi i kryerjes së detyrave të punës nga pozicioni paraprak ne cilësinë e menaxherit te projekteve dhe menaxhimi i kontratave me Telekom, IPKO, KEDS e operator tjerë, evidentimi, kontrolli analitik dhe efiçient dhe procesimi për pagesë të shpenzimeve mujore energjetike e telekomunikuese, ofrimin e zgjidhjeve teknike, hartimin e paramasave e parallogarive, kujdesi për mbarëvajtjen operative të infrastrukturës fizike të njësive punuese të Kompanisë.

*** Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarra për eliminimin e humbjeve teknike.**

- Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale.
- Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – detektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zonave për detektim.
- Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatorëve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatorëve në shërbime dhe investime për funksionimin sa me efikas të furnizimit me ujë të pijes.

**Prodhimi i ujit $m^3$ - Janar-Dhjetor, 2021**

| Muaji | Prodhimi mujor m3 | Prodhimi ditor- m3 | Prodhimi (l/sec) |
|---|---|---|---|
| Prizren | 12,038,640 | 32,982.58 | 381.7 |
| Suharekë | 2,498,480 | 6,845.15 | 79.2 |
| Dragash | 1,014,982 | 2,780.77 | 32.2 |
| Malishevë | 1,376,402 | 3,770.96 | 43.6 |
| **Total** | **16,928,504** | **46,379.46** | **536.8** |

**Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Janar-Dhjetor, 2021**

| Njësia Operative | Ujësjellësi- uji i pijes | Kanalizimi | Total |
|---|---|---|---|
| **Prizren** | 1,835 | 678 | 2,513 |
| **Suharekë** | 391 | 149 | 540 |
| **Dragash** | 42 | 28 | 70 |
| **Malishevë** | 501 | 161 | 662 |
| **Total** | **2,769** | **1016** | **3,785** |

## Zyra për planifikim dhe zhvillim – Janar - Dhjetor, 2021

* Përpilimi i pëlqimeve, përgjigjeve në kërkesa për konsumatorët.
* Mbikqyrje në projektet e kompanisë dhe donatoreve, si ato te CDI-së në qytetin e Prizrenit dhe zonat rurale të Prizrenit, Rr. Remzi Ademi ne Prizren, etj.
* Mbikqyrje në projektin ”Inspektimi me CCTV” nga KWE (sistemi i kanalizimit).
* Bashkepunimi me ARRU.
* Përpunimi dhe prezentimi i raportit për CCTV si dhe prezentimi i 12 km të sistemit të kanalizimit për rehabilitim në qytetin e Prizrenit – projekt nga KFW.
* Bashkepunimi me këshillin ndërministror të ujërave në Kosovë.
* Përpilimi i Plan Bisnesit 2022-2024.
* Përpilimi i dokumentacionit për SCADA SISTEM dhe përcjellja e tyre te HWTC- Hungari
* Revidimi i listës për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit Faza V.
* Vizit zyrtare për trajnim “UMT”, Republika Çeke .
* Pjesëmarrje virtuale në Koferencën e ujërave dhe platforma tjera digjitale.
* Rregullimi i rregullatorëve të shtypjës në fshatin Gjonaj (Urim Bytyqi).
*

* Bashkepunimi me Komunën e Prizrenit me Inxhinierët e DSHP-së për realizimin e projekteve të përbashkëta dhe atë që janë në plan nga K.Komunal si dhe mundësia e vazhdimit të bashkëpunimit ndërmjet dy insitucioneve.
* Matje gjeodezike dhe aktivitete të ndryshme profesionale për nevoja të kompanisë.
* Digjitalizimi i konsumatoreve në GIS për njësitë e Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.
* Përpunimin e të dhënave të terenit, vendosjen e të dhënave në GIS. Databaza e konfiguruar nga ana e Sherbimit Teknik dhe MMS-Tool çdo ditë bëhen backup dhe ruhen në serverin e Kompanisë dhe në paisje alternative për siguri.
* Verifikimi i konsumatoreve në hartë, regjistrimi i të dhënave (kons. emri dhe mbiemri), regjistrimi i rekordeve që nuk kanë numër të rekordeve në hartë, futja e shënimeve në rekorde të reja (kons.emri dhe mbiemri) si dhe lidhja e rekordeve në programin Navision – GIS.
* Grupi i Bllombimit për muajt Janar-Dhjetor, është angazhuar për evidentimin e konsumatorëve të cilët faturohen vetëm me faturë të ujit dhe jo atë të kanalizimit (konsumatoret që nuk paguajnë apo nuk faturohen me sistem të kanalizimit), poashtu edhe në bllombim të ujëmatësave:

| | Prizren Total –Gjithsej | Total |
|---|---|---|
| 1 | Bllombim-Kontrata | 1217 |
| 2 | Ribllombime | 631 |
| 3 | Dera Mbyllur | 3485 |
| 4 | Kërkes nga konsumatori | 140 |
| 5 | Zevendesim | 53 |
| 6 | Regjistrim i ri | 23 |
| 7 | Duhet regjistruar | 01 |

## Raporti i aktiviteteve dhe analizat bakteriologjike Janar – Dhjetor, 2021

**Aktivitetet tjera :**

Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje, qytet e fshatra.
Kontrolli përmanet i kualitetit të ujit në burime dhe puse të cilat shfrytëzohen për momentin.
Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorifikimit mbi mbarvajtjen e procesit dhe paisjeve.
Furnizim i stacioneve të klorifikimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.
Marrja e mostrave sipas planit të monitorimit intern .
Bëmë riparimin si dhe zevendesimin e pompes per klorifikim në komorën e re në ”40 Burime”, në gypin Ø600mm.
Bëmë riparimin e sistemit të klorinimit në stacionin ,,Pusi i Atit’’ ku ndërruam vakum rregullatorin , rrotometrin dhe injektorin për arsye se të më parshmit ishin jashtë funksionit si pasoj e vjetërsisë së tyre.

Kontrolle të vazhdueshme 24 orë në “40 Burime” për shkak të reshjeve të mëdha dhe rritjes së turbiditetit dhe mundësisë së futjes në sistem sa ma parë që është e mundur burimet të cilat ishim të detyruar që ti largonim nga rrjeti.
Te stacioni i klorinimit në ,,Bunar-1’’ndërruam pjes fazonike(ventil) afër pompës së klorinimit.
Në fshatin Gjonaj riaktivizuam sistemin e klorinimit te komora mbledhëse nga ,,Gurra”.
Monitoruam dhe raportuam mbi punët e kryera nga punë kryesi ,,Diamanti’’mbi aparaturat e vendosura për klorinim të ujit të pijes në zona rurale (faza e dytë).
Kemi riaktivizuar sistemin e tushave në stacionin e klorinimit, si masë e krijimit të sigurisë në punë në raste avarie me klor.
Në rezervuarin e Zhur-it kemi instaluar komplet paisjet për një qeshme e cila nevoitet për krijimin e tretësirës se Hipokloritit të Natriumit.
Për shkak të punimeve në stacionin e pompave në ,,Bunar-1’’ na u kërkua që për një kohë të caktuar ta ndalim klorinimin në gypin Ø 400 ,dhe pasi u sanua problemi në pompa na u dashtë të intervenojmë në sistemin e klorinimit sepse ishte mbushur me ujë.
Riparuam sistemin e klorinimit në ,,Bunar-1’’konkretishtë vakum regullatori ishte mbushur me ujë dhe bëmë pastrimin e tijë dhe ventilave poashtu edhe injektorin në gypin Ø300 në drejtim të rezervuarit në ,,KFOR’’ i cili ishte jashtë funksioni për arsye se kishte ardhur deri te plasaritja e gypit që e përqon klorin.
Në stacionin e pompimit dhe klorinimit në ,,Sozi’’ montuam një lëshues (rubinet)në pompat që dërgojnë ujin në drejtim të Kobajt që të kemi mundësi ta kotrollojmë ujin me sasi të klorit që dërgohet në këto fshatra, poashtu kemi rregullu sistemin e klorinimit ku ishte jashtë funksionit sepse kishte avari nga dëmtimi i injekltorit në gypin Ø800, riparuam dhe pastruam tërë sistemin.
Vizit në objektet e KRU-së dhe pregaditëja e një raporti mbi mangësit që duhet sanohen në të ardhmen, kryesisht në stacionet e klorinimit.
Në stacionin e pompimit dhe klorinimit në ,,Sozi’’ së bashku me Ingjinierin e firmës ,,Diamanti’’ si dhe ekspertët nga Shqipëria punuam që sistemi i klorinimit të funksionon ashtu si duhet dhe me angazhimin e tyre arritë që ta fusin nën kontroll te tere sistemin (lidhjen në mas PLS-së dhe Pompës).
Në stacionin e pompimit dhe klorinimit në Vërmicë së bashku me Ingjinierin e firmës ,,Diamanti’’ si dhe ekspertët nga Shqipëria punuan që ta ndërrojnë pompën e klorinimit e cila është 25 bar (se pompa paraprake ishte 10 bar) e nuk kishte mundësi ta bënte injektimin e klorit në gyp, mirëpo futjen në funksion me pranin tone nuk e kanë bërë.
Kemi vizitu edhe stacionin e ri të klorinimit në ,,Sopi’’ të ndërtuar nga firma ,,Diamanti’’e cila i ka testuar aparaturat dhe sipas saj janë në rregull, po këto teste e ka bërë pa prezencën tonë.
Riparuam sistemin e klorinimit në stacionin e klorinimit në ,,Bunar-1’’ si dhe bëmë pastrimin e tërë sistemit të klorinimit.
Përgjigjja në ankesat e dy qytetarëve në lidhje me kualitetin e ujit, vizit në shtëpit e konsuamatorëve ku bëmë identifikimin dhe sanim e problemit.
Instaluam dhe futëm në funksion sistemin e klorinimit në ,,TOPALLNICË’’-Suharekë.
Në stacionin e klorinimit në komorën e re në ,,40-Burime’’riparuam Vakum rregullatorin dhe e rikthyem në funksion.
Në mënyrë sistematike kontolluam kualitetin e “Pusit 2” në Novak për disa ditë pa ndërprerë.

Jemi përgjigjur ankesës së konsumatorit për kualitet të ujit në Arbanë-Prizren.
Kemi pasur takim pune me përfaqsuesit e ARRU-së dhe i kemi furnizur me dokumentacionin e kërkuar nga ana e tyre.
Riparuam pompën e klorinimit si dhe vakumrregullatorin në komorën e re në "40-Burimet".
Përcjellje permanente e kualitetit të ujit për shkak të rritjes së turbiditetit sidomos pas luhatjes së energjisë elektrike,
Me kërkesën e Menagjerit të ITU-të zeza kemi shkuar regullish per disa ditë për ta përcjell sasinë e klorit në objekt dhe në qendrën e trajtimit të ujit.
Kemi pasur trajnim me të gjithë punëtorët të cilët janë të angazhuar me punë me Klor, të organizuar nga SHUKOS-i dhe IKSHP-ja.

**Analizat Bakteriologjike, Janar - Dhjetor / 2021**

| Njësia | Lloji i ujit | Nr. i mostrave bakteriologjike | Nr. i mostrave që nuk përgjigjen |
|---|---|---|---|
| Prizren | Burim<br>Ujësjellës | 52<br>115 | 34<br>10 |
| Suharekë | Burim<br>Ujësjellës | 7<br>46 | 4<br>6 |
| Dragash | Burim<br>Ujësjellës | 11<br>30 | 11<br>3 |
| Malishevë | Burim<br>Ujësjellës | 7<br>37 | 7<br>7 |
| **Totali** | | **305** | **26** |

**Vrejtje:** 1) Në burim, uji i patrajtuar ; 2) Ujësjellës, uji i trajtuar

**Analizat Bakteriologjike, ISHP-Prizren, Janar- Dhjetor / 2021**

| Njësia | Lloji i ujit | Nr. i mostrave bakteriologjike | Nr. i mostrave që nuk përgjigjen |
|---|---|---|---|
| Prizren | Burim<br>Ujësjellës | 28<br>844 | 0<br>0 |
| Suharekë | Burim<br>Ujësjellës | 6<br>117 | 0<br>0 |
| Dragash | Burim<br>Ujësjellës | 4<br>52 | 0<br>0 |
| Malishevë | Burim<br>Ujësjellës | 6<br>111 | 0<br>0 |
| **Totali** | | **1168** | **0** |

**Vërejtje:** Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësjellësit është **1124** mostra dhe të gjitha mostrat i pergjigjen standarteve të ISHP-së.

### 3.1.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas herëshme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

### 3.1.5 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Të gjitha defektet në sistem të ujësjellësit dhe kanalizimit janë sanuar me kohë,
- Është përcjell në mënyre përmanente cilësia e ujit të pijës në nivel regjional,
- Është përgaditur dhe miratuar strategjia e UPF-së.

### 3.1.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

-Monitorimi i furnizimit me ujë të pijës në gjithë zonën e sherbimit,
-Monitorimi i cilësisë së ujit të pijes në nivel regjional,
-Vazhdimi i analizës së rrejtit të ujësjellësit dhe bartja e të dhënave në GIS,
| Sherbim me internet dhe DTV ne pikat e kompanise se KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a 6 lote LOT III 40 Burimet dhe 40 Burimet 2 | HJ-21-021-221 | 30.09.2021 Anulim | | | | |
| Sherbim me internet dhe DTV ne pikat e kompanise se KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a 6 lote LOT IV Pusi Atit | HJ-21-021-221 | 30.09.2021 Anulim | | | | |
| Sherbim me internet dhe DTV ne pikat e kompanise se KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a 6 lote LOT V Novak | HJ-21-021-221 | 03.12.2021 | 12.12.2023 | Lot V "Ipko Telecommunications | 216,00€ | |
| Sherbim me internet dhe DTV ne pikat e kompanise se KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a 6 lote LOT VI Baqevc | HJ-21-021-221 | 03.12.2021 | 12.12.2023 | Lot VI "Ipko Telecommunications | | |
| Furnizim me kater aparate mobile | HJ-21-022-136 | 28.10.2021 | 16.12.2021 | N.N.SH "A& E COM" | 1,500,00€ | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Furnizim me dru | HJ-21-023-136 | 25.10.2021 | 26.11.2021 | NDERMARRJA TREGTARE SHERBYESE "TINI" | 1,798.8€ | |
| Furnizim me makina zyrtare per ushtrimin e aktiviteteve te perditshme ne teren nga ekipet operative LOT I-Furnizim me 3 automjete te vogla | HJ-21-024-121 | | | | | ANULUAR |
| Furnizim me makina zyrtare per ushtrimin e aktiviteteve te perditshme ne teren nga ekipet operative LOT II-Furnizim me 3 kamioneta me kiper | HJ-21-024-121 | | | | | ANULUAR |
| Ritender-Furnizim me makina zyrtare per ushtrimin e aktivteteve te perditshme ne teren nga ekipet operative LOT I-Furnizim me 3 automjete te vogla LOT II-Furnizim me 2 kamioneta me kiper | HJ-21-024-121 | | | | | ANULUAR |
| Sigurimi I automjeteve | HJ-21-025-236 | | | | | ANULUAR |
| RITENDER-Sigurimi I automjeteve | HJ-21-025-236 | | | | | Ne procedur |
| Rehabilitimi I gypit PEHD O 110mm,ne rrugen TREPCA | HJ-21-027-521 | 22.12.2021 | 04.11.2021 | "K-ING" SHPK | 53,065.12€ | |
| Furnizim me 17 cope aparate per lexim te barkodeve te faturave | HJ-21-028-136 | 22.12.2021 | 28.12.2021 | Comtrade Computers O.K | 3,481.16€ | |
| Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit PEHD O 90 mm, në fshatin KOBAJ - Prizren. | HJ-21-029-536 | | | | | Ne procedur |
| Shërbime të veqanta Kontabilist i Certifikuar | HJ-21-030-236 | | | | | Ne procedur |
| Kontrollimi teknik i automjeteve | HJ-21-031-236 | | | | | Anuluar ne mungese te ofertuesve |

## 9. TRANSAKSIONET KRYESORE TE KRYERA GJATË VITIT 2021

| Nr. | DATA | Nr. i Dokumentit | Emri I Konsumatorit | Shuma |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 12/23/2021 | 1021 | P2M Berlin GmBH | 85,290.45 |
| 2 | 12/23/2021 | 1019 | P2M Berlin GmBH | 72,512.93 |
| 3 | 12/20/2021 | AL-0019168 | P2M Berlin GmBH | 67,181.77 |
| 4 | 12/20/2021 | AL-0019169 | P2M Berlin GmBH | 57,227.00 |
| 5 | 12/20/2021 | AL-0019170 | P2M Berlin GmBH | 56,790.01 |
| 6 | 12/17/2021 | NLB-P-00025205 | KEK - Bunari I | 53,394.91 |
| 7 | 12/23/2021 | 1020 | P2M Berlin GmBH | 52,392.21 |
| 8 | 12/20/2021 | AL-0019171 | P2M Berlin GmBH | 51,777.24 |
| 9 | 3/9/2021 | 3504- | Aqualia | 49,614.76 |
| 10 | 10/22/2021 | BPBPZNPOS-002165 | Burimi-Com sh.p.k. | 49,176.39 |
| | | | **TOTAL** | **595,357.67** |

**Tabela e pagesave nga Xh.ll. Sipas vleres me te madhe**

| Nr. | DATA | Nr. i Dokumentit | Emri I Konsumatorit | Shuma |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 14.12.2021 | 159729 | Qendra Medicinale SPITALI | 9,634.58 |
| 2 | 25.10.2021 | NLB-P-00020852 | Qendra Medicinale SPITALI | 8,629.54 |
| 3 | 28.12.2021 | NLB-P-00020127 | Qendra Medicinale SPITALI | 7,986.94 |
| 4 | 25.10.2021 | NLB-P-00022611 | Qendra Medicinale SPITALI | 7,440.30 |
| 5 | 15.10.2021 | PCB-P-00097759 | Qendra Medicinale SPITALI | 6,476.17 |
| 6 | 14.12.2021 | PCB-P-00105747 | " 17 Shkurti " Sh.Fillore Bajë | 5,933.10 |
| 7 | 31.12.2021 | NLB-P-00022120 | Qendra Medicinale SPITALI | 5,349.20 |
| 8 | 26.10.2021 | BPBPZNPOS-000978 | "Naim Frasheri" Sh.Fillore Baje | 5,346.08 |
| 9 | 06.10.2021 | PCB-P-00081850 | K.R.U "Gjakova" Sh.A - Nj. Prizren | 4,979.45 |
| 10 | 28.12.2021 | NLB-P-00020853 | "Labinot Krasniqi" Sh.Fillore Mirushë | 4,708.32 |
| | | | **TOTAL** | **66,483.68** |

# 10. DRAFT PASQYRAT FINANCIARE – 2020-2021

## K. R. U. " HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A.

### DRAFT-Pasqyra e pozitës financiare

### më 31 dhjetor 2021

| | Shënimi | 2021 | 2020 |
|---|---|---|---|
| | | € | € |
| **PASURITË** | | | |
| **Pasuritë afatshkurtra** | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | 3 | 1,349,695 | 414,080 |
| Investimet financiare afatshkurtra | | | - |
| Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera | 4 | 4,850,976 | 5,334,539 |
| Stoqet | 5 | 601,693 | 617,408 |
| Pasuritë e tjera afatshkurtra | 6 | 10,161 | 9,552 |
| **Gjithsej pasuritë afatshkurtra** | | **6,812,525** | **6,375,578** |
| **Pasuritë afatgjata** | | | |
| Investimet në pjesëmarrje | | - | - |
| Investimet në filiale | | - | - |
| Investimet financiare afatgjata - objekte ndertimore | 7 | 32,898,910 | 27,222,170 |
| Prona, pajisjet dhe impiantet | 7 | | |
| Prona investuese -tokat | 7 | | |
| Investimet në vijim | 7 | | |
| Pasuritë e paprekshme | 7 | | |
| Pasuritë e shtyra tatimore | | | |
| Pasuritë e tjera afatgjata | 7 | | |
| **Gjithsej pasuritë afatgjata** | | **32,898,910** | **27,222,170** |
| **Gjithsej pasuritë** | | **39,711,436** | **33,597,748** |

## DETYRIMET DHE EKUITETI

**DETYRIMET**

**Detyrimet afatshkurtra**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Mbitërheqja bankare | | - | - |
| Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera | 8 | 2,641,135 | 2,464,880 |
| Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër | 9 | 3,997 | 18,760 |
| Interesi i pagueshëm | | | - |
| Tatimin në fitim i pagueshëm | | | - |
| Provizionet afatshkurta | | | - |
| Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkurtër | | | - |
| Detyrimet e tjera afatshkurtra ( detyri. ndaj kons.ne parapagim ) | 10 | 83,729 | 54,503 |
| **Gjithsej detyrimet afatshkurtra** | | **2,728,862** | **2,538,143** |
| **Detyrimet afatgjata** | | | |
| Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë | 11 | 8,186 | 8,186 |
| Provizionet afatgjata | | | - |
| Detyrimet ndaj lizingut, pjesaafatgjatë | | | - |
| Detyrimet e shtyra tatimore | 12 | 1,522,763 | 1,732,380 |
| Detyrimet e tjera afatgjata | 13 | 19,791,975 | 13,547,095 |
| **Gjithsej detyrimet afatgjata** | | **21,322,924** | **15,287,661** |
| **Gjithsej detyrimet** | | **24,051,786** | **17,825,804** |
| **EKUITETI** | | | |
| Kapitali aksionar | 16 | 25,000 | 25,000 |
| Fitimet - humbjet e mbajtura | 16 | (4,761,286) | (4,663,970) |
| Fitimi - humbja e vitit | 16 | 193,178 | (141,175) |
| Rezervat e tjera | 16 | 14,574,432 | 14,574,432 |
| Rivlersimi I aseteve | | 5,628,326 | 5,977,657 |

| | | |
|---|---|---|
| **Gjithsej ekuiteti** | **15,659,650** | **15,771,944** |
| **Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet** | **39,711,436** | **33,597,748** |

*Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv (ZKF )*

*Drejtori Financiar*

*Kontabilisti i Certifikuar*

___________________ ____________________ _________________

***Zenel Zenelaj***

***Ibrahim Bajraktari***

***Emil Sylejmani***

## K. R. U. " HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A.

### DRAFT-Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
### për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

| | Shënimi | 2021<br>€ | 2020<br>€ |
|---|---|---|---|
| Të hyrat | 14 | 5,181,404 | 4,552,892 |
| Kostoja e shitjes | | - | - |
| **Fitimi / (humbja) bruto** | | **5,181,404** | **4,552,892** |
| Të ardhurat tjera | 14 | 387,155 | 1,154,188 |
| Shpenzimet e shpërndarjes | 14 | (3,380,847) | (3,351,093) |
| Shpenzimet administrative | 14 | (509,553) | (537,190) |
| Shpenzimet e amortizimit-zhvlersimit | 14 | (873,431) | (1,024,740) |
| Shpenzimet e tjera | 14 | (611,551) | (935,233) |
| **Fitimi / (humbja) operativ** | | **193,178** | **(141,175)** |
| Shpenzimet financiare | | - | - |
| Të ardhurat financiare | | | |
| **Fitimi / (humbja) para tatimit** | | **193,178** | **(141,175)** |
| Shpenzimet e tatimit në fitim | | | |
| **Fitimi / (humbja) i/e vitit** | | **193,178** | **(141,175)** |
| | | **-** | **-** |
| **Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:** | | | |
| Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi | | | |
| **Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit** | | **-** | **-** |
| | | **-** | **-** |
| **Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit** | | **193,178** | **(141,175)** |

## 11. PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

### Qellimet dhe objektivat strategjike për vitin 2022

Si qellime kryesore të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. jane:

- Kontinuiteti i vazhdueshëm i prodhimit te ujit të pijshëm,
- Kontrolla e kualitetit të ujit të pijshëm të jetë në pajtim me instruksionet e lëshuara ngarregullorret në fuqi.
- Rritja e shkallës se inkasimit si dhe zvogëlimi i ujit të pafaturuar
- Rritja e shkallës së efikasitetit të punëtorëve.

### Objektivat kryesore të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A

- Mirëmbajtja e stabilimenteve Elektro-makinerike,
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet dhe evitimin e prishjeve me kohë,
- Aktivitetet në përfundimin e projekteve për instalimin e ujëmatëseve,
- Përpjekjet që çdo konsumatori ti matet sasia e ujit të shpenzuar dhe ti bëhet faturimi në bazë të sasisë së ujit të shpenzuar,
- Pasurimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhëna të reja,
- Përpjekjet maksimale në identifikimin e klientëve të rinj,
- Angazhimi në mbledhjen e borxheve të vjetra si dhe inkasimi i faturave rrjedhëse,
- Identifikimi dhe rritja e numrit te konsumatorëve përfshirë këtu edhe lidhjet ilegale,
- Vazhdimi i informimit të konsumatorëve dhe bashkëpunimi me organet komunale ne mënyrë që shfrytëzimi i ujit të bëhet në suaza normale,
- Trajnimi i kuadrove në fusha të ndryshme si: në teknologjitë bashkëkohorë të trajtimit të ujerave të pijshëm dhe ujërave të zeza, në fushën e ekonomisë, financave, etj.

## 12. INVESTIMET E REALIZUARA
## JANAR- DHJETOR 2021
### KRU – ,,HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A

### KRU – HIDROREGJIONI JUGOR

| NR. | EMRI I PROJEKTIT | PËRSHKRIMI I PROJEKTIT | PUNËMARRËSI | KRU - HJ |
|---|---|---|---|---|
| | **Projekti** | **nr.fat-prokur.** | **Furnitori** | **Vlera e Asetit** |
| 1 | Lidhje shtepiake | dalje 64,65/21 | HRJ | 1,116.18 |
| 2 | Paisje dhe makineri te ndryshme | fat.17112018 | Moni | 1,411.87 |
| 3 | St.pompues Topalnicë-Sr. | hj-21-012-521 | Hiterem | 40,700.59 |
| 4 | St.pompues Topalnicë-Sr. | hj-21-012-521 | BG-Ing | 7,876.91 |
| 5 | St.pompues Topalnicë-Sr. | dalje 120,121,465,466 | HRJ | 6,548.06 |
| 6 | Sportel per arka | 01.07.21 | 4 ing | 1,639.24 |
| 7 | Blerje pomave dhe servisimi | 01deri 24/921 | Elektroni | 42,145.77 |
| 8 | Paisje-karrigë,klima,projektor | te ndryshme | As-tech,AE,Infinit | 8,394.26 |
| 9 | Printer mobil dhe lexues barkodi | 04/21,81224 | AE+Comtrade | 4,612.58 |
| 10 | Paisje IT | fat.ndryshme | Mediatech | 9,445.75 |
| 11 | Nddrimi rrjetit ujit në Banjë-Ma | nr.prot.1497 | HRJ(xerxa) | 3,697.35 |
| 12 | Rruga"R.Ademi"Pz | hj-0484/21 | G Projekti | 5,395.83 |
| 13 | Zhvendojsa gypit fi 60 Sopij Sr | hj-982 | HRJ | 1,984.13 |
| 14 | Rrjet uji"I.Mazreku"Ma | hj-21-018-521 | K-ing+xerxa | 41,285.82 |
| 15 | Mirmbajte ne fshatin Gjonaj Pz | hj-1232-2021 | Xerxa | 7,331.38 |
| | **TOTAL** | **Vet financim KRU** | | **183,585.72** |

**INVESTIMET E REALIZUARA**

| | **JANAR-DHJETOR 2021** | Donacion | Vetfinacim-HRJ |
|---|---|---|---|
| 1 | **Asete Vetfinacimi HRJ 2021** | **-** | **183,585.72** |
| **2** | **Investim ne vijim vetfinacim** | **-** | **7,523.73** |
| 3 | **total Donacion Komuna Pz 2021** | **110,922.81** | **-** |
| 4 | **total Donacion Komuna Sr 2021** | **24,978.81** | **-** |
| 5 | **Investim ne vijim Donacion** | **516,641.37** | **-** |
| | **Total investimi 2021** | **652,542.99** | **191,109.45** |

# 13 INVESTIMET E PLANIFIKUARA

## 13.1 PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE

Plani i Investimeve është një pjese e rëndësishme e Planit te Biznesit, i cili i mundëson ujësjellësit të përmirësojë shërbimet ndaj konsumatore. Përmirësimi i shërbimeve do të ndikojë edhe në përmirësimin e moralit të pagesave tek konsumatorët.

Plani i investimeve do te përbëhet prej një përzierje te projekteve, ku disa prej tyre do te jene pjese e financimit nga Kompania nga te ardhurat e tyre. Megjithatë ekziston një numër i projekteve të mëdha të cilat kërkojnë financim te jashtëm edhe vlerësim te detajuar.

Qëllimi i Planit te Investimeve është qe te siguroje se Kompania është duke bere planifikim te përshtatshëm për mirëmbajtjen e rregullt dhe zhvillimin e infrastrukture se ujësjellësit.

Identifikimi i investimeve, me qellim te arritjes se ndryshimeve te standardeve te kualitetit apo shërbimeve shqyrtohet sipas vlerësimit te gjendjes se aseteve qe janë ne dispozicion me qellim te arritjes se gadishmerise teknike te pajimeve. Këto investime planifikohen të jenë pjesë e grandeve nga KfW, MZHE, MEF, Kuvendi Komunal si dhe nga mjetet vetanake të Kompanisë.

Ne baze te analizës dhe gjendjes momentale qe kemi ne teren, ne kemi përcaktuar prioritete e investimeve ne nivel te Kompanisë-Ndjesive punuese.

Këto prioritete janë te domosdoshme ngase:

- përmirësohet dukshëm furnizimi me ujë
- përmirësohet cilësia e ujit
- zvogëlohen humbjet teknike dhe komerciale
- shtohet numri i konsumatoreve te rinj
- zvogëlohen shpenzimet operative te mirëmbajtjes
- rritet shtimi i shërbimeve te Kompanisë
- evitohet mundësia e ndotjes se ujit te pijes nga ujerat e zeza

Planifikimi i investimeve për vitin 2020-2021-2022 është bazuar, në mundësinë e thithjeve të donacioneve si dhe programeve impementuese te Donatorë

## 14. RAPORT NGA MENAGJERET E PROJEKTEVE

### 14.1 Ndërtimi i kolektorit dhe Impiantit për Trajtimin e Ujerave te zeza – Prizren (ITUN)

Si rezultat I gjendjes jo te kënaqshme te shërbimeve me sistemin e kanalizimit ne aspektin e funksionalitetit për te përballuar ujerat urbane ne përgjithësi duke përfshirë ujerat e zeza, ujerat industriale dhe ujerat e shiut ne qytetin e Prizrenit , ka rrjedh nevoje qe te përpilohet një studim I mirëfilltë për gjendjen e ujerave urbane për qytetin e Prizrenit, prandaj është filluar me Studimin e Fizibilitetit te përpiluar ne vitin 2006 te investuar nga Qeveria Federale Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), konkretisht versionit final te këtij studimi 10/2011 për Asgjësimin e Ujerave te Ndotura ne Kosovën Jugperëndimore, konkretisht Studimi I Fizibilitetit per qytetin e Prizrenit me nr. te projektit 610-1154 , me te vetmin qellim për te ngrite shkallen sanitare për qytetin e Prizrenit ne përgjithësi, për te mbrojtur shëndetin e popullatës, ujerat nëntokësore, ujerat sipërfaqësore ne veçanti, e sidomos për te përmbushur një nder kriteret e Bashkimit Evropian qe Ujerat e Ndotura te shkarkohen ne shtetet tjera si te trajtuara.
Bazuar ne ketë studim te Fizibiltetit si baze për zhvillimin e këtij projekti na është dhuruar granti nga Qeveria Federale Gjermane I cili është realizuar me automatizëm nga ish Presidentja e Republikës se Kosovës shkëlqesia e saje zonja Atifete Jahjaga, ky Grant I pastër pa asnjë interes është jetësuar përmes dy Marrëveshjeve Financiare te projektit ndërmjet KfW-se si dhurues, Ministrisë se Financave si marres dhe KRU”Hidroregjionit Jugor” si përfitues I këtij Granti te nënshkruara ne vitin 2012.
Marrëveshja e pare është ne vlere prej 8 milion euro (7+1) dhe marrëveshja e dyte është ne vlere prej 4 milion Euro. *(Marrëveshjet financiare origjinale te nënshkruara nga palët gjenden ne Kompaninë KRU”HRJ”sh.a dhe munde te prezantohen ne çdo moment)*.
Pas këtyre marrëveshjeve financiare për ketë Project është përpiluar Marrëveshja e Veçantë e cila është jetësuar me nënshkrimin e saje ndërmjet palëve si: Banka Gjermane për Zhvillim si investitor, Ministria e Mjedisit dhe planifikimit Hapsinor si garantuese e fondit nga kontributi vendor, Komuna e Prizrenit – si garantuese e sigurimit te lokacionit ku do te ndërtohet ITUN, konkretisht shpronësimit te tokës se nevojshme për ndërtimin e ITUZ-se dhe fondeve eventuale shtese te cilat do te nevojiten për kompletimin e këtij projekti dhe KRU”Hidroregjionit Jugor” si Agjencion Ekzekutues I Projektit.
Për implementimin e këtij projekti me inicimin e KfW-se është përcaktuar Agjent Tenderi I cili ka përzgjedhur Kompaninë Konsulentë e cila ka për detyre qe te përgatisë dokumentacionin e tenderit, te dizajnoj projekte sipas kontratës dhe te mbikëqyr projektin deri ne fund te implementimit për te dy fazat e projektit. Kontrata me Kompaninë konsulentë është nënshkruar ne vitin 2013.
Projekti përbëhet prej dy fazave, Faza 1 ka te beje me ndërtimin e kolektorit kryesor ne rruge ana e majte e rrjedhës se lumit Lumëbardhi se bashku me kapërderdhësit për reshjet e shiut, faze kjo e cila tani me është përfunduar dhe Faza 2, Dizajnimi dhe ndërtimi ITUZ-se e cila është shume afër përfundimit.
Kontrata “Asgjesimi i Kanalizimeve në Jugperëndim të Kosovës; Faza 2 - Dizanjimi, furnizimi dhe instalimi i WWTP në Prizren ”u nënshkrua më 5 Maj 2015 midis Punëdhënësit Hidroregjioni Jugor dhe Kontraktuesit, Sipërmarrje e përbashkët (Joint Venture) Aqualia infraestructuras S.A. (si udhëheqës) dhe Hidroterm.

**Kushtet e kësejë kontrate Dizajn dhe Ndërtim vlejnë sipas Librit te verdhe te FIDIK-ut (FIDIC Yellow Book, Edition 1999). Procedurat e Prokurimit per këtë kontrate u zhvilluan sipas Udhëzimeve të Prokurimit të KfW-se.**
Për shkak të vonesave në shpronësimin e tokës dhe çështjeve tjera administrative absolutisht pa fajin e AEP-se qe ka te beje me posedimin e Lejes së Ndërtimit si kusht themelor per fillimin e zbatimit te

kantatës , ndërtimi i WWTP Prizren filloi më **25 qershor 2017**, ndërkaq kontrata me punë kryesin ishte nënshkruar me

**5 Maj 2015** qe nënkupton se punimet kishin filluar me një vonese prej 26 muajve, për ketë vonese punëdhënësi bazuar ne marrëveshjen kontraktua le ka qene I obliguar qe te paguaj kompensim prej rreth 320,000.00 Euro neto, këto mjete janë paguar nga komuna e Prizrenit si garantuese e kostos shtese. Kohëzgjatja fillestare e kontratës ishte 18 muaj dhe Data e Përfundimit te projektit u caktua me **31 Dhjetor 2018.**

Gjatë tremujorit të dytë 2018, përparimi i punimeve të ndërtimit filloi të ngadalësohet ndjeshëm. Vonesat kanë ndodhur për shkak të procesit të ngadaltë në marrjen e aprovimit nga KEDS per dislokimin e linjes 10 KV (kilovolteshe) e cila duhej te dislokohej dhe kjo leje është lëshuar ndërkohë si dhe përparimit relativisht te ngadaltë te disa pjesëve të punëve civile.

Për shkak të kushteve të këqija të motit në dimër përfshirë vitet 2017/2018, në tetor te vitit 2018 sipas konsulences dhe miratimit te KfW-se u vendos që koha e perfundimit te projektit te zgjasë edhe per dy muaj, pra u vendos qe projekti te perfundoj deri me **28 shkurt 2019**.

Sidoqoftë, për shkak të performancës së pakënaqshme të Kontraktuesit, u bë e qartë se punimet e ndërtimit do të zgjasin më shumë. Punëdhënësi HRJ dhe Konsulenti kanë zhvilluar takime të shumta me Kontraktorin për të shpejtuar përparimin e punimeve.

Konsulenti me miratimin e HRJ-se I ka derguar leter kontraktorit Ne muajin Shtator dhe Tetor te vitit 2018 bazuar ne Klauzolen 8.6 te FIDIK-ut qe ka te beje me “Shkallen e progresit te punimeve” me te cilen e ka njoftuar per shkallen e ngadalte te progresit te punimeve dhe ne Janar te vitit 2019 nje leter tjeter per “nivelin e performances se paknaqshme” duke I kerkuar qe te marr masa per rikuperimin e ketyre vonesave.

Pas shume takimeve dhe presioneve tek kontaktori nga ana e kosnulentit dhe HRJ-se në një takim te dates 6 Mars 2019, Kontraktori emëroi një "Menaxher të ri te Përkohshëm të Ndërtimit" për të mbështetur Ekipin e Kontraktuesit në vendpunishte deri në perfundimin apo venien ne funksion te impiantit. Me kete angazhim nga Kontraktori fillimi i komisionimit ishte fundi i **qershorit 2019** dhe kjo dukej akoma realiste, mirpo me gjithë optimizmin e përkohshëm, i cili doli nga ai takim, problemet në vendpunishte mbetën të njëjta. Kontraktuesi vazhdonte të tejkalonte orarin e tij dhe I neglizhonte udhëzimet e dhëna nga Konsulenti.

Prandaj, ne si Punëdhënës me udhezimet nga konsulenti e konsideruam veten qe kemi të drejtë qe te na paguhen demet nga keto vonesa dhe me date **24 maj 2019** e njoftuam me shkrim Kontraktuesit per kete çeshtje.

Në qershor, u vlerësua se para-komisionimi i WWTP Prizren do të fillonte në shtator 2019.

Pas shqetesimit nga KfW si financuese e ketije projekti dhe neve si punedhenes u inicua takimi I parë Special I cili u mbajt në **4 korrik 2019** në zyrën e KfW në Prishtinë. Gjatë Takimit special, u ra dakord per një sërë aktivitetesh te mehershme që duhej të kishin përfunduar deri në shtator 2019 për te pas mundesi inaugurimin e perfundimit te ketije projekti pargjate festimit te 20 vjetorit të Bashkëpunimit Financiar Gjerman me Kosovën.

Më tej në takim, Kontraktuesi dorëzoi Raporte Javore të Progresit që raportojnë për përparimin e pikave të shtatorit. Inxhinieri monitoroi përparimin gjatë mbikëqyrjes së tij të përditshme të vendpunishtes dhe takimeve javore me Kontraktorin.

Pavarësisht nga kjo, Konsulenti vërejti se progresi ishte prapa afateve të dakorduara dhe se nuk u mor asnjë masë serioze nga Kontraktuesi për të shpejtuar përparimin. Si pasojë, Konsulenti lëshoi disa udhëzime tek Kontraktuesi, duke specifikuar kohën deri në të cilën punimet duhet të përfundojnë.

Gjatë Takimit te dyte Special te mbajtur ne zyret e HRJ-se me date **21 Gusht 2019**, përfaqësuesi i KfW në Kosovë, Drejtori i Përgjithshëm i HRJ dhe Konsulenti kërkuan që numri i punëtorëve në vendpunishte të rritet ndjeshëm.

Aktualisht, rreth 95% e punimeve të ndërtimit kishin përfunduar, por Kontraktori po përballet me vështirësi të përmbushë disa kërkesa të KEDS për transformatorin. Këto kërkesa duhet të përmbushen para se WWTP të lidhet me rrjetin e furnizimit me energji elektrike.
Me kusht që këto probleme të tejkalohen shumë shpejt, Kontraktori parashikon që ITUZ mund të merret në veprim në **dhjetor 2019**.
Duke rishikuar kërkesën e HRJ për pagesa, Inxhinieri "p2m berlin GmbH-IDOM-ALB Architect" përcaktoi që pas **28 shkurtit 2019**. me letrën e tij të datës 26 gusht 2019 në lidhje me përcaktimin për aplikimin e dëmeve të vonesës, Inxhinieri përcaktoi që Punëdhënësi, Hidroregjioni Jugor, ka të drejtë në përputhje me **FIDIC YB, SC 8.7** [Dëmtimet e vonesës] për pagimin e dëmeve të vonesës nga Kontraktori pas datës **6 Korrik 2019**.

Periudha e aplikimit të dëmeve të vonesës u përcaktua të zgjasë deri në leshimin e certifikates per pranim teknik te perkohshem (Taking over certificate).
Periudha maksimale për aplikimin e Dëmeve të Vonesës ka skaduar me 14 Tetor 2019. Kjo do nenkuptoj qe eshte plotesuar vlera e demeve nga 10 % I kontrtaes dhe pas kesaj date HRJ mund te filloj me aplikimin per kompenzim e nje pjese te demeve per shkak te vonesave.
Prandaj, HRJ ka të drejtë për shumën maksimale të dëmeve të vonesës (10 (dhjetë)% të çmimit të kontratës përfundimtare në shumën prej 1,035,451.24 EUR në përputhje me FIDIC YB, SC 8.7 [Dëmtimet e vonesës]. Në këtë kusht eksperti FIDIC-ut nga ana e Inxhinierit-konsulences konfirmoi që Hidroregjioni Jugor ka të drejtë të dergoje nje kerkese per kompenzimin e demeve para se te leshohet Pranimi Teknik I perkohshem. *(Gje te cilen e kundershtonte kontraktori, duke thene se pa perfunduar komplet projekti dhe te percaktohet vlera investive nuk kemi te drejte te kerkojme demet per shkak te vonesave, gjithashtu kontestone kohen e cila u shkaktua ne kontestin e kontraktorit me KEDS-in).*
Në përputhje me kontratën, dëmet e vonesës do të llogariten në bazë të çmimit përfundimtar të kontratës. Sidoqoftë, kjo nuk nënkupton që Dëmtimet e Vonesës mund të aplikohen vetëm pasi të merren punimet dhe të gjitha variacionet dhe pretendimet janë zgjidhur dhe mbyllur.
Në përputhje me **FIDIC YB, SC 2.5** [Kërkesat e punëdhënësit], shumat e pjeseshme të dëmeve të vonesës tashmë mund të zbriten nga IPC-të para se të lëshohet TOC Pranimi Teknik i perkohshem.
Në këtë drejtim, synohet të zbritet një pjesë e dëmeve të vonesës nga faturat e Kontraktuesit për Kërkesën Nr. 13 (483,339.78 EUR) dhe për Shlyerjen e Parave të Mbajtjes së MESP (481.871.02 EUR). Mbetjet e dëmeve të vonesës arrijnë në 1,035,451.24 - 483,339.78 - 481,871.02 = 70,240.44 EUR. Synohet të zbritet kjo pjesë e mbetur e dëmeve të vonesës nga faturat e rradhës të Kontraktuesit.
Me date 23.06.2021 pas kekeses nga ana e kontraktorit per marrjen e qertifikates se pranimit te perkoheshem teknik parciale (per linjen e ujit) te dorezimit te projektit ku kjo kerkese eshte shqyrtuar nga kompania konsulente P2M Berlin, me miratimin e kesaj kerkese nga konsulenca atehere eshte pranuar dhe eshte bere dorezimi nga kontraktori tek punedhenesi i pjeses se linjes se ujit.
Me date 07.10.2021 pas kekeses nga ana e kontraktorit per marrjen e qertifikates se pranimit te perkoheshem teknik parciale (per linjen e llumit) te dorezimit te projektit ku kjo kerkese eshte shqyrtuar nga kompania konsulente P2M Berlin, me miratimin e kesaj kerkese nga konsulenca atehere eshte pranuar dhe eshte bere dorezimi nga kontraktori tek punedhenesi per pjesen e linjes se llumit.
Me date 03.11.2021 eshte bere inaugurimi i projektit, ku te pranishem ishin te gjitha institucionet vendore dhe nderkombetare si dhe donatoret e projektit.

## Programi Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim  në Zonat Rurale Faza e VI-të

*Jemi në  fazen Finalizimin e projekteve realizim   të planifkuara për  fazës së VI-të ku disa projekte jane perfundue  disa ne fazen  perfundimtare  :

**Në Prizren :**

- investimet ne Aparaturat e klorinimit te ujit  janë ne fazen garancionit

**Projekte e reja** :

**Në Suharekë:**

*Projekte e sistemeve të reja të ujësjekllësave në fshtrat ,Suharekë, Reqan, Neprebisht, Maqitevë , punimet kan përfundue ,jemi ne fazen e testimeve të rrjetit dhe rezervareve .

*Humbjet e ujit ;

Fshati Reshtan  ndërtimi i rrjetit kryesor dhe ndërtimi i pusetave në trotuar  dhe montimi i ujëmatësave per tërë fshatin , janë në fazen  e garancioneve  .

* Ndërtimi i impiantit biologjik për trajtimin e ujrave të zeza  në fshatin Bukosh , punimet ne fazen perfundimtare

| Nr | Projektet | Nr. Prokurimit | Data | Vlera e kontrtes(€ ) | Kontraktuesit e Punimeve | Vërejteje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndertimi I Sistmit  te ujesjellesit per Fshatrat e Komunen  MA , Fsh.Janqisht ;Temeqinë | | | | N.N SH "Alafa -I" | Faza e garancionit |
| 2 | Ndertimi I Sistmit  te ujesjellesit per Fshatrat e Komunen  Su , Fsh.Maqitevë | | | | N.N.SH" K-Ingu”Prishtinë | Faza e garancionit |
| 3 | " Rehabilitimi i zonave të matura të ujit (ZMU) ,për zvogëlimin e ujit të pafaturuar (UPF) RESHTAN - SUHAREKË - RITENDER..” | 0-19-6728-5-2-1 | 3/10/2019 | 146,825 | N.N.SH" K-Ingu”Prishtinë | Faza e Garancionit |
| 4 | " Trajtimi I ujit  -  Aparatura per klorinim  të ujit në Sopi; Prizren :Vermicë, Dragash; Brezne | | | | N.N.SH" “Diamanti " | Faza e Testimeve |
| 5 | Impianti per trajtimin e ujrave te perdorura  -Fsh. Bukosh Suharekë | | | **123,000** | N.N.SH" K-Ingu " | Zhvilimi I punimeve |

## RAPORT NGA MENAXHERI I PROJEKTEVE

## Programi: Mënjanimi i ujërave të ndotura në Europën Jugperëndimore ( Faza V)

| | |
|---|---|
| Titulli i projektit; | “Inspektimi me CCTV dhe shërbimet tjera për rrjetin e kanalizimit në Prizren”. |
| Përfituesi; | KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A – Prizren |
| Donatori; | Qeveria Gjermane–KFW/BMZ–2015.6705.6/Prizren–V/WC-1.3 |
| Agjensioni financiar; | KFW – Banka zhvillimore |
| Fondi total i programit; | 8 mln Euro |
| Data e Marrëveshjes; | 04.10.2019 |
| Palët e marrëveshjes; | 1. KFW,<br>2. Ministria e Financave e Republikës së Kosovës<br>3. KRU “Hidroregjoni Jugor” Sh.A, Prizren<br>4. KRU Hidrodrini” – Pejë<br>5. KRU “Gjakova” – Gjakovë |
| Konsulenca; | SRP, Schneider + Partner<br>Hidroing-DK |
| Punëmarrësi; | “KWE – Kosova Water and Energy” shpk, Prishtinë |
| Kontrata; | 3551/26.11.2019 |
| Vlera e kontratës së nënshkruar; | **612.215.00 €** |
| **Vlera e kontratës së realizuar;** | **549,024.02 €** |
| Data e fillimit të punimeve; | 13.01.2020 |
| Plani dinamik I paraparë; | 18.10.2020 (300 ditë kalendarike) |
| Plani dinamik i reviduar; | 26.12.2020 |
| Përfundimi i punimeve; | 01.03.2021 |
| Çertifikata e pranimit teknik: | 12.04.2021 |
| Periudha e përgjegjësis: | 02.03.2021 ÷ 01.03.2022 (365 ditë) |

**Statusi i fillimit të punimeve;**

Fillimi i punimeve zyrtarisht është data 13.01.2020 me takimin e parë konsultativ të mbajtur me punëmarrësin – KWE, me pjesëmarrjen e konsulences dhe menaxhmentit të Kompanisë. Temë e takimit ishte përgatitja dhe dorëzimi I dokumentacionit final për fillimin e punimeve dhe dakordimi për datën.

KWE është zotuar që deri me datën 20.01.2020 të përgatisë dhe dorëzoj dokumentacionin e kërkuar dhe në teren të fillojnë me datën 28.01.2020.

Punimet në teren kanë filluar me datën 18.02.2020 si rezultat i kushteve atmosferike dhe plotësimit dhe dorëzimit të dokumentacionit të paraparë.

KRU "Hidroregjioni Jugor", ka proceduar dokumentacionin e duhur për aplikim në institucionet relevante për marrjen e Pëlqimeve dhe lejeve përkatëse për zhvillimin e punimeve nga kontraktori.

**Përshkrimi i punimeve;**

1. Pastrimi I rrjetit me presion me ujë
2. Inçizimi dhe inspektimi me CCTV
3. Testimi I rrjetit me tym
4. Testimi I rrjetit me ngjyrë

Makineria, stafi dhe paisjet tjera përcjellëse ishin në përputhshmëri me dokumentacionin e prezentuar dhe kanë përmbushur kriteret e parapara për ekzekutimin e punimeve.

**Efekti covid-19:**

Me datën 13.10.2020, kontraktori ka kërkuar kompensimin e ditëve të humbura të punës si rezultat i pandemisë COVID – 19 përkatësisht Vendimeve Qeveritare për ndërprerje të punimeve. Konsulenca ka nxjerrur Vendimin për aprovim me dokumentacionin determinues për periudhën kohore 16.03.2020-03.05.2020.
Me datën 08.12.20320, kontraktori ka paraqitur kërkesën e dytë për aprovim të ditëve të humbura për shkak të efektit të pandemisë, për periudhën kohore 29.9.2020 – 20.11.2020 dhe konsulenca ka aprovuar dokumentacionin determinues me të dhënat si më poshtë:

**VO1, nr. 2821/1, datë: 16.11.2020, 49 ditë pune………… 24,990.00 €**
**VO2, nr. 832, datë; 07.04.2021, 46 ditë pune……….. 00.00 €**

**Ndëshkimi për vonesë;**

Për shkak të vonesave përkatësisht mosekzekutimit të punimeve pa arsye nga kontraktori gjatë periudhës kohore 11.02.2021 – 01.03.2021, me kërkesën e Menaxherit të projektit të KRU "Hidroregjioni Jugor", Sh.A, dhe aprovimin e konsulencës me shkresën e datës 12.04.2021, janë kalkuluar 18 ditë pune për ndëshkim sipas vlresës 0.1% të vlerës ditore sipas kontratës:

**18 ditë pune x 637.21 € = 11,499.69 €**

Kjo vlerë i është reduktuar kontraktorit nga shuma finale për pagesë.

**Statusi i punimeve finale:**

1. Përfundimi I punimeve: 01.03.2021
2. Pastrimi I rrjetit me presion me ujë; L = 20,487.95 m
3. Inçizimi dhe inspektimi me CCTV; L = 20,211.80 m
4. Testimi I rrjetit me tym; L = 20,198.00 m
5. Testimi I rrjetit me ngjyrë; L = 19,367.00 m
6. Matja me GPS dhe integrimi në sistemin GIS L = 18,870.00 m
7. Numri i pusetave te investiguara; 191

**Pagesat e ekzekutuara**:

| | |
|---|---|
| Avansi në vlerë; | 122,443.00 **€ (20 %).** |
| IPC 1……… | 48,333.15 **€** |
| IPC 2……… | 182,779.82 **€** |
| VO1.......... | 24,990,00 **€** |
| IPC 3......... | 167,443.35 **€** |
| **Gjithsej:** | **549,024.02 € (86.50 %)** |

**Të gjeturat dhe konstatimet:**

- Disa segmente të rrjetit të kanalizimit të sendimentuara mbi 50 %
- Disa puseta të mbyllura plotesisht gjatë rehabilitimit të rrugëve
- Disa linja me sasi të ujit në rrjetë të kanalizimit mbi 70 %
- Shumë segmente me gypa të dëmtuar, të shtypur apo devijuar
- Cilësia e ujit të ndotur në shumë linja të rrjetit me parametra shumë të ulët se të pritura si rezultat I rrjedhjeve të ujit të pijshëm dhe ujërave atmosferik.
- Kyçjet ilegale të konsumatorëve në rrjetin e kanalizimit
- Rrëshqitja e dheut/devijimi I gypave
- Gypat që janë të instaluar nga viti 2000 nuk i plotësojnë kriteret teknike për kanalizim

**Përfitimet:**

- Pasurimi i të dhënave në GIS për rrjetin e investiguar të kanalizimit
- Pastrimi kualitativ i rrjetit të kanalizimit dhe pusetave
- Identifikimi i segmenteve të sakta për rehabilitim dhe rekonstruktim
- Identifikimi i pusetave për rehabilitim dhe rekonstruktim
- Identifikimi i segmenteve të rrjetit në gjendje të mirë teknike
- Rrjedhje - shkarkim i mirë i ujërave të ndotura te ITUN e qytetit
- Identifikimi I prishjeve dhe rrjedhjeve të ujit të pijes

**Sfidat:**

- Ndërprerjet e punimeve në disa etapa për shkak të efektit të pandemisë COVID – 19.
- Mungesa e informacioneve për disa puseta të cilat janë të mbuluara nga kontraktorët komunal gjatë ndërtimit të rrugëve me asfalt, kubëza etj.
- Sendimentimi I lartë dhe zënia e plotë e gypave të kanalizimit.

**Rekomandimet:**

- Gjatësia e rrjetit për rehabilitim dhe rekonstruktim – 11 km (+/- 1 km)
- Pastrimi gjeneral periodik I rrjetit të kanalizimit dhe pusetave nga njësitë operative të Kompanisë apo kontraktimi I kompanive private të specializuara për këtë veprimtari
- Dixhitalizimi optimal I rrjetit të kanalizimit
- Lokalizimi dhe riparimi i rrjedhjeve të ujit të pijes për zvogëlimin e humbjeve
- Asistimi profesional dhe I vazhdueshëm i ekspertëve të Kompanisë dhe bashkëpunimi I ngushtë me Drejtiorinë e Shërbimeve Publike pranë KK- Prizren dhe institucionet tjera që planifikojnë dhe realizojnë projekte investive në infrastrukturën e gjithëmbarshme rrugore e ujore me qëllim të zbatimit të kritereve e standardeve teknike optimale për ndërtimin e tyre.

**Projektet tjera të filluara dhe në proces të implementimt:**

1. Faza V&VI -Programi; Menjanimi i ujërave të ndotura ne Kosoven Jugperendimore.
   Projekti; Rehabilitimi I rrjetit te kanalizimit ne Prizren.
   L = 8.75 km
   Vlera investive; 4,432,338.89 €
   Burimi financiar: Qeveria Gjermane dhe Qeveria e Kosovës
   Implementuesei: Institucioni zhvillimor financiar – KFW
   Kod: BMZ 2015 6705 6 & 2016 67 583

2. Studim fisibiliteti për projektin (në proces):
   “Implementimi i SCADA sistemit per kontroll, monitorim dhe automatizim te sistemit te ujesjellesit ne te gjitha zonat menaxhuese të Kompanise.
   Burimi finaciar: Qeveria e Kosovës
   Implementuesi: “Korporata hungareze e teknologjike se ujit” - HWTC.

3. Projekte përkrahëse për avansimin professional të stafit.

   a. MIA – Menaxhimi I integruar I aseteve
      Burimi financiar: WB & IAWD & KRU “Hidroregjoni Jugor”, Sh.A
      Implementuesi: GIZ& & Hydrocomp & IAWD & SHUKOS
   b. UBP- Utility Bench Marking program
      Burimi financiar dhe implementuesi: IAWD (Austri)

**STRUKTURA ORGANIZATIVE**
**KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN**

